


ALBPETROL SH.A.

Pasqyrat Financiare

Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(Me raportin e audituesit të pavarur bashkëlidhur)

Raporti i auditorëve të pavarur	-
Bilanci	1
Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve	2
Pasqyra e ndryshimeve në kapital	3
Pasqyra e flukseve të arkës	4
Shënimet e pasqyrave financiare	
1. Shenime të përgjithshme	7
2. Baza e përgatitjes	10
3. Përmbledhje e politikave kontabël	11
4. Administrimi i riskut financiar	22
5. Aktivët të qëndrueshme të trupezuara	26
6. Aktivët Biologjike Afatgjata	28
7. Aktivët Afatgjata jo Materiale	29
8. Aktive Afatgjata të tjera Materiale	30
9. Inventari	31
10. Llogari të arketueshme	32
11. Mjete monetare në arkë dhe bankë	32
12. Kapitali aksioner	33
13. Llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme	35
14. Detyrime ndaj punonjësve	35
15. Detyrime të tjera	35
16. Detyrime të tjera dhe gjendjet kreditore	36
17. Grantet	36
18. Provizionet	36
19. Detyrime afatgjata	37
20. Te tjera detyrime afatgjata(K/Parti)	37
21. Te ardhurat	38
22. Kosto materialeve dhe shpenzime të tjera operative	38
23. E ardhura financiare neto/shpenzime	38
24. Tatimi mbi të ardhurat	39
25. Ngjarje pas dates së bilancit	39



Pronareve te
ALBPETROL SH.A

Tiranë, 29 Korrik 2014

Raport mbi Pasqyrat Financiare

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të bashkëngjitura të Albpetrol Sh.a. , të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2013, pasqyra e veçantë e të ardhurave, pasqyra përmbledhëse e të ardhurave, pasqyra e ndryshimeve në kapitalin e vet dhe pasqyra e flukseve të parave për vitin e mbyllur në atë datë, dhe shënimet që përfshijnë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe për një kontroll të brendshëm, të tillë siç drejtimi vendos se është i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Përgjegjësia e Audituesve

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Auditimi ynë u bë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të marrim një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare nuk kanë anomali materiale.

Auditimi ka të bëjë me kryerjen e procedurave për të marrë evidencë auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Kur vlerëson këto rreziqe, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm të entitetit mbi përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare në mënyrë që të planifikojë procedura të përshtatshme auditimi në rrethanat përkatëse të entitetit, por jo me qëllim që të shprehë një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi gjithashtu ka të bëjë me vlerësimin e përshtatshmërisë së metodave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, si dhe me vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë me rezerve.

Bazat për dhënien e Opinionit me Rezerve:

1. Aktivitet Afatgjata Materiale

Ne aktivitet te tjera afatgjata (banesa) te shoqërisë është paraqitur vlera e banesave te punonjësve për vlerën 211,518,753 leke, kurse ne fakt vlera e tyre është 316,042,982 leke (me pak 104,524 mijë leke).



Sipas V.K.M. Nr.470, date 31.08.2000, këto aktive i kalojnë për administrim Entit Kombëtar të Banesave por gjatë vitit 2013 nuk janë kryer veprime për këtë transaksion.

Per shkak të realizimit të inventarit fizik në muajt Shtator-Tetor 2013, nuk kemi marrë pjesë.

Shoqëria nuk ka bërë asnjë vlerësim të zhvlerësimit, siç udhëzohet nga *SNK 36 "Zhvlerësimi i Aktiveve"* nëse Aktivitet Afatgjatë Materiale janë zhvlerësuar. Shoqëria nuk ishte në gjendje të na pajiste me informacion me dokumentacion mbështetës të mjaftueshëm dhe të përshtatshëm në lidhje me zhvlerësimin e këtyre aktiveve. Duke patur parasysh regjistrimet e Shoqërisë dhe në mungesë të procedurave alternative audituese, ne nuk u bindëm për vlerësimin e këtyre aktiveve

Shoqëria nuk ishte në gjendje të na pajiste me informacion me dokumentacion mbështetës të mjaftueshëm dhe të përshtatshëm në lidhje me numërimin fizik të Aktiveve. Duke patur parasysh regjistrimet e Shoqërisë dhe në mungesë të procedurave alternative audituese, ne nuk u bindëm për ekzistencën, plotësinë dhe vlerësimin e Aktiveve Afatgjatë Materiale.

Për shkak të natyrës të regjistrimeve të përshkruara më sipër, ne nuk ishim në gjendje të përcaktonim se cilat veprime rregulluese kontabël mund të ishin të nevojshme në Aktivitet Afatgjatë Materiale të Shoqërisë me 31 Dhjetor 2013.

2. Zhvlerësimi i kërkesave të arketueshme

Në bilancin kontabël të shoqërisë është paraqitur zhvlerësimi i kërkesave të arketueshme në shumën 642,939,837 leke i pa ndryshuar nga bilanci kontabël i vitit 2011.

Shoqëria ka shtuar Llogari në pritje për 740,188,657 leke, nga e cila priten mos arkëtime dhe Shoqëria duhej të llogariste provigjone për këto të arketueshme.

Shoqëria nuk ka përcaktuar metodat që duhej të përdoren në llogaritjen e zhvlerësimit të kërkesave të arketueshme dhe nuk ka kryer detajimin e sakte të tyre.

Shoqëria nuk ka llogaritur zhvlerësimin e kërkesave të arketueshme për faturat e papranuara nga klienti kryesor ARMO sha.

Në kushtet e mësipërme nuk mund të përlllogaritet efekti i rregullimeve të nevojshme për t'u kryer në lidhje me saktësinë e shumës së zhvlerësimit të kërkesave të arketueshme për periudhën që mbyllet me 31 Dhjetor 2013.

3. Zhvlerësimi i inventarit dhe Provizionet për detyrime.

Shoqëria nuk ka kryer testin e zhvlerësimit të inventarit (materiale për përdorim në prodhim) në datën e mbylljes së bilancit. Vlerësimi i produktit të gatshëm është bërë me çmim mesatar të shitjes.

Shoqëria nuk ka krijuar provizione për detyrimet që rrjedhin nga dëmtimi i mjedisit gjatë zhvillimit të aktivitetit të saj.

Në kushtet e mësipërme nuk mund të përlllogaritet efekti i rregullimeve të nevojshme për t'u kryer në lidhje me shumën e testit të zhvlerësimit të inventarit dhe shumën e provizionit për detyrime mjedisore në datën e mbylljes së bilancit.



4. Tatimi i shtyre

Për shkak të natyrës dhe kufizimeve të çështjeve të parashtruara më sipër, ishte e pamundur të siguronim evidence të përshtatshme dhe të mjaftueshme për të gjykuar nëse tatimi i shtyre është i sakte dhe i plotë.

Ne kushtet e mësipërme nuk mund të përlllogaritet efekti i rregullimeve të nevojshme për t'u kryer në lidhje me shumën e tatimit të shtyre në datën e mbylljes së bilancit.

Opinionit

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve që rrjedhin nga çështjet e mësipërme, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të sinqertë në të gjitha aspektet materiale, gjendjen financiare të Shoqërisë më 31 Dhjetor 2013, rezultatit të saj financiar dhe flukset e saj të parave për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.


Ekspertet Kontabël të Regjistruar

ANILA CUNOTI

Anila Cunoti

BERTI PASHKO

Berti Pashko



ETLEVA ASHIKU

Etleva Ashiku



KASTRIOT HAXHAJ

Kastriot Haxhaj



RAMAZAN ADEMI

Ramazan Ademi



Tirane, me 29 Korrik 2014

ALBPETROL Sh.a.

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013+

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lek)

	Shënime	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Të ardhura	21	9,162,822,980	11,938,922,088
Të ardhura të tjera operative neto	21	1,367,733,276	(4,135,693,005)
Ndryshime në inventar të produkteve të përfunduara dhe punimeve në process		(125,827,876)	231,311,708
Puna e kryer nga njesia per qellimet e veta dhe e kapitalizuar			2,938,560
		10,404,728,380	8,034,540,791
Kosto e materialeve të para	22	(4,622,130,294)	(547,222,608)
Shpenzime personeli	22	(2,197,042,229)	(2,231,800,375)
Shpenzime amortizimi dhe zhvlerësimi	22	(477,299,377)	(442,901,301)
Shpenzime të tjera operative	22	(1,650,924,808)	(2,946,938,949)
		(8,947,396,708)	(6,168,863,233)
Rezultati nga të ardhurat operative		1,457,331,672	1,865,677,558
Të ardhura financiare	23		
Shpenzime financiare	23	(1,439,592)	(435,953,520)
Kosto financiare neto		(1,439,592)	(435,953,520)
Fitimi para tatimit		1,455,892,080	1,429,724,038
Tatimi mbi fitimin	24	(202,532,334)	(275,442,562)
Fitimi neto i periudhës		1,253,359,746	1,154,281,476

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve duhet të lexohet e ndërthurur me shënimet shoqëruese si pjesë përbërëse e pasqyrave, të paraqitura nga faqja 6 në 39.



ALBPETROL Sh.a.
 Bilanci më 31 Dhjetor 2013
 (Të gjitha shumat janë të shprehura në Lek)

Aktivi	Shënime	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	5	47,303,084,638	48,141,744,434
Aktive afatgjata jo materiale	7		131,857,322
Investime në shoqëri	8	1,052,717,052	936,766,318
Totali i aktiveve afatgjata		48,355,801,690	49,078,510,752
Inventari	9	7,508,145,030	7,725,862,209
Llogari të arkëtueshme	10	14,667,349,506	14,713,431,907
Aktive të tjera	6	120,833	120,833
Mjete monetare në arkë e bankë	11	793,200,558	18,429,922
Totali i aktiveve afatshkurtra		22,968,815,927	22,457,844,871
Totali i aktivitet		71,324,617,617	71,536,355,623
Kapitali			
Kapitali aksioner	12	13,360,997,000	13,360,997,000
Rezerva		44,726,640,522	43,869,311,159
Fitimi i mbajtur		1,253,359,746	1,154,281,476
Totali i kapitalit		59,340,997,268	58,384,589,635
Detyrimet			
Huate afatgjata	19	137,169,788	147,627,783
Huamarrje te tjera afatgjata		0	0
K/Parti (banesa)	20	211,518,753	211,518,753
K/Parti (AAM për jashtë përdorimit)	20	240,098,860	240,098,860
Totali i detyrimeve afatgjata		588,787,401	599,245,396
Llogari të pagueshme	13	7,281,933,941	7,778,818,442
Detyrime ndaj punonjësve	14	103,531,684	349,697,160
Hua te tjera	16	308,261,676	1,002,583,725
Detyrime tatimore afatshkurtra	15	226,620,901	198,887,865
Detyrime të tjera – detyrime ndaj shtetit (dividend)	16	3,357,308,663	3,097,595,331
Grandet dhe te ardhura te shtyra	17	87,176,083	94,938,069
Provizione afatshkurtra	18	30,000,000	30,000,000
Totali i detyrimeve afatshkurtra		11,394,832,948	12,552,520,592
Totali i detyrimeve		11,983,620,349	13,151,765,988
Totali i kapitalit dhe i detyrimeve		71,324,617,617	71,536,355,623



Bilanci kontabël të lexohet i ndërthurur me shënimet shoqëruese si pjesë përbërëse e pasqyrave,
të paraqitura nga faqja 6 në 39.



ALBPETROL Sh.a.

Pasqyra e ndryshimit në kapital për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013 dhe 2012

(Të gjitha shumat janë të shprehura në 000 Lek)

	Shënim i	Kapitali aksioner	Primi aksionit	Rezerva ligjore	Rezerva të tjera	Rezerva e rivlerësimit	Fitimi i pashpërndarë	Kapitali UM Patos, UM Kucove	Totali
Balanca më 31 Dhjetor 2011		10,388,375	14,046,688	178,226	-	33,527,980	3,441,773	872,808	62,455,850
Rritja e rezervës									
Rivlerësimi i aktiveve të qëndrueshme	5					(2,951,101)			(2,951,101)
Shpërndarja e fitimit të mbajtur	14								-
Dividend i paguar									-
Sistemime nga rivlerësimi I AAM						(1,019,828)	(3,441,773)		(3,441,773)
Primi aksionit			87,346						(1,019,828)
Kapitali UM Patos, UM Kucove								(872,808)	87,346
Fitimi i vitit							1,154,281		(872,808)
Emetimi aksioneve		2,972,622							1,154,281
Balanca më 31 Dhjetor 2012		13,360,997	14,134,034	178,226	-	29,557,051	1,154,281	-	2,972,622
Rritja e rezervës						865,711			58,384,589
Shpërndarja e fitimit të mbajtur									865,711
Sistemime nga rivlerësimi I AAM						(8,382)			0
Dividend per tu shpërndarë									0
Fitimi i vitit							(1,154,281)		(8,382)
Balanca më 31 Dhjetor 2013		13,360,997	14,134,034	178,226	0	30,414,380	1,253,360	0	(1,154,281)
							1,253,360		1,253,360
							1,253,360		59,340,997

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet e ndërthurur me shënimet shoqëruese si pjesë përbërëse e pasqyrave, të paraqitura nga faqja 6 në 39.



ALBPETROL Sh.a.

Pasqyra e flukseve të arkës për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013 dhe 2012 (vazhdim)


Flukset e arkës nga aktivitetet financuese

Pagese dividenti	0	(3,441,772,590)
Flukset e arkës të gjeneruara nga aktivitetet financuese	<u>0</u>	<u>(3,441,772,590)</u>
Rënia neto në mjetet monetare në arkë dhe në bankë	774,770,636	(30,414,828)
Mjete monetare në arkë dhe në banke në fillim të periudhës	18,429,922	48,844,750
Mjete monetare në arkë dhe në bankë në fund të periudhës	793,200,558	18,429,922

Pasqyra e flukseve të arkës duhet të lexohet e ndërthurur me shënimet shoqëruese si pjesë përbërëse e pasqyrave, të paraqitura nga faqja 6 në 39.

Pasqyrat Financiare u aprovuan më datën 29/07/2014 nga Këshilli Mbikëqyrës dhe u firmosën në emrin e tij nga:

Endri Puka
Administratori



Enkelejda Peshkepia
Shefi i Departamentit të Financës



ALBPETROL Sh.a.

Shënime e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(Shumat në Lek nëse nuk specifikohet ndryshe)

1. Shënime te përgjithshme

ALBPETROL Sh.a (“Shoqëria”) është një shoqëri anonime shqiptare, ka për objekt operacionet e kërkimit, te zhvillimit dhe prodhimit të hidrokarbureve si dhe çdo veprimtari tjetër të mundshme dhe të ligjshme në përputhje me interesat e saj, siç përcaktohen në Statutin e Shoqërisë dhe në Vendimin e Gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë

Shoqëria është themeluar në bazë të Vendimit të Gjykatës Nr. 21158 datë 8 Prill 1999 sipas regjistrimit tregtar, bazuar në ligjin Nr. 7638, datë 19 Nëntor 1992 “Mbi shoqëritë tregtare”. Selia e shoqërisë është në adresën Patos, Fier.

Kapitali i nënshkruar i saj është 13.360,997,000 leke, i ndare në 13,360,997 aksione me vlerë nominale 1,000 leke secili. Kapitali i paguar është regjistruar në Lek.

Të gjitha aksionet e ALBPETROL Sh.a janë nën pronësinë e Shtetit Shqiptar të përfaqësuar nga ana e Ministrisë të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

Drejtuesit e Shoqërisë është si më poshtë:

- Këshilli Mbikëqyrës
- Bordi i Drejtorëve

Këshilli i Mbikëqyrjes aktual së ALBPETROL-it përbëhet si më poshtë:

1.	Koli	BELE	Anëtar
2.	Kastriot	BEJTA	Anëtar
3.	Ardit	KAMBERI	Anëtar
4.	Andius	OLLDASHI	Anëtar
5.	Artur	METANI	Anëtar
6.	Ardit	ÇOLLAKU	Anëtar

Administratori i shoqërisë: Endri PUKA

Veprimtaria e përditshme e shoqërisë drejtohet nga Administratori, të cilit, i përketin të gjitha kompetencat për drejtimin ekzekutiv dhe përfaqëson shoqërinë në marrëdhëniet me të tretet.

Gjate periudhës 01.01.2013 deri me 31.12.2013 shoqëria ka kryer aktivitetin e saj në përputhje me objektin e krijimit të saj.

Në përputhje me veprimtarinë dhe organizimin administrativ, shoqëria ka organizuar kontabilitetin në 12 njësi vartëse ose qendra, të cilat përgatisin secila Pasqyra Financiare me vete dhe nxjerrin rezultat të vecante. Në Qender, shoqëria përgatit Pasqyrën Financiare Përmbledhese të bilanceve kontabel të njëjësive të saj. Kontabiliteti në Qender është i informatizuar, ndërsa në njësitë vartëse mbahet në menyre të përzier edhe manuale edhe të informatizuar.

Në çdo tremujor nga Departamenti i Finances janë përgatitur dhe paraqitur Pasqyrat Financiare nëpër njësi dhe Qender si edhe rezultatet analitike të Sektoreve të ndryshëm të veprimtarisë.

Në sugjerimet tona Për një funksionim me efikas të kontabilitetit të shoqërisë, kemi në konsideratë punën e bere, por në të njëjtën kohë duhet të përmirësohet akoma me shume organizimi kontabel për të mbështetur në kohe reale me informacione drejtimin e shoqërisë, i cili të ndermarre veprime në të mirën e shoqërisë.



ALBPETROL Sh.a.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(Shumat në Lek nëse nuk specifikohet ndryshe)

Auditi i brendshëm

Ne shoqërinë Albpetrol sh.a. ekzistojnë procedura dhe programe që synojnë të ndikojnë në mbrojtjen e pasurisë, ruajtjen e interesave të pronarit të vetëm, zbulimin e anomalive dhe parregullsive, saktësimin e informacioneve ekonomiko-financiare, etj.

Për ndjekjen e kësaj pune vepron Departamenti i Auditit të Brendshëm, i cili ka varësi të plote nga Keshilli Mbikqyres. Ky i fundit orienton, harton dhe miraton programet dhe planet e kontrollit për Departamentin e Auditit të Brendshëm, i cili është pjesë e kontrollit të përgjithshëm shtetëror dhe ushtron veprimtarinë e tij konform ligjeve, vendimeve të Keshillit të Ministrave dhe metodikave të hartuara nga strukturat e ngarkuara nga Keshilli i Ministrave për këtë qellim. Auditi i brendshëm nuk është në përbërjen e strukturave të tjera të shoqërisë ALBPETROL SH.A.

Kështu gjatë vitit 2013 Departamenti i Auditit të Brendshëm ka kryer kontrole të plota ekonomike dhe financiare sipas programit dhe planit të hartuar dhe ka nxjerre rezultatet e tyre.

Bazuar në strategjinë e zhvillimit të shoqërisë, ku prioritet i veçantë i është dhënë thithjes së investimeve të huaja, gjatë vitit 2013 është rritur ndjeshëm bashkëpunimi i shume kompanive të huaja me eksperience në zhvillimin e vendburimeve të naftës dhe të gazit për kërkim-zbulimin e zhvillimin e vendburimeve që administrojnë Albpetrol.

Në zbatim të Marrëveshjeve Hidrokarbure me kompanitë “Bankers Petroleum Albania” Ltd, “Stream Oil & Gaz” Ltd, “Sherwood”, “IEC Visoke” dhe “Phoenix”, nga momenti i fillimit të marrëveshjeve dhe deri më 31.12.2013.

Tabela e mëposhtme jep numrin e puseve sipas çdo kompanie që vepron në baze të Marrëveshjes së Hidrokarbureve:

Nr.	Emërtimi Kompanisë	Nr. puseve dorëzuar deri në fund të vitit 2012	Nr. puseve dorëzuar në vitin 2013	Nr. puseve dorëzuar deri në fund të vitit 2013
1	Bankers Petroleum	1,133	0	1,133
2	Stream Oil&Gaz	374	0	374
	a) Vendburimi CA-MO	69	0	69
	b) Vendburimi BA-HE	23	0	23
	c) Vendburimi GO-KO	295	0	295
	d) Vendburimi Delvine	4		4
3	Sherwood	12	0	12
4	IEC Visoke	235	0	235
5	Phoenix Petroleum		490	490
	Gjithsej	2,145	490	2,635

Gjatë vitit 2013 deri në datë 31 dhjetor janë dorëzuar gjithsej edhe 490 puse të tjerë si më poshtë:



ALBPETROL Sh.a.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(Shumat në Lek nëse nuk specifikohet ndryshe)

<i>Emërtimi Qendrës</i>	<i>Data e dor.te 2013</i>	<i>Aktiv</i>	<i>Jo aktiv</i>	<i>Dorëzuar</i>
<i>Bankers Petroleum</i>				0
<i>Stream Oil&Gaz</i>				0
<i>Sherwood</i>				0
<i>Transoilgrup</i>				0
<i>Phoenix Petroleum</i>		45	445	490
<i>vb naft Amonice</i>	02/09/2013	23	37	60
<i>vb naft Drashovice</i>	02/09/2013	1	68	69
<i>vb naft Pekisht-Muriz</i>	02/09/2013	6	9	15
<i>vb gaz Frakull</i>	03/09/2013	4	29	33
<i>vb gaz Panaja</i>	03/09/2013	1	0	1
<i>vb gaz Povelçë</i>	03/09/2013	2	18	20
<i>vb gaz Ballaj-Kryevidh</i>	03/09/2013	1	71	72
<i>vb gaz Divjakë</i>	03/09/2013	7	161	168
<i>vb gaz- kondesatFiniq-Krane</i>	04/09/2013	0	52	52
Totali		45	445	490

Numri punonjesve.

Gjendja fizike me 31/12/2013 2,226 punonjës, ndërsa numri mesatar 2,893 punonjës.
Gjendja fizike me 31/12/2012 2,988 punonjës, ndërsa numri mesatar 2,936 punonjës.



ALBPETROL Sh.a.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(Shumat në Lek nëse nuk specifikohet ndryshe)

2. Baza e Përgatitjes

2.1 Deklarata e Përputhshmërisë së pasqyrave financiare

Pasqyrat Financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (IFRS).

2.2 Baza e matjes

Pasqyrat financiare paraqiten në Lek, e cila është monedha funksionale e Shoqërisë. Ato janë përgatitur bazuar në koston

2.3 Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare paraqiten në Lek, e cila është monedha funksionale dhe e paraqitjes të pasqyrave financiare të Shoqërisë.

2.4 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me IFRS kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, vlerësime dhe perlllogaritje, të cilat kanë efekte në aplikimin e politikave kontabel dhe në vlerat e aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Vleresimet dhe perlllogaritjet janë bazuar në përvijën e mëparshme dhe në faktore të tjera, të cilat drejtimi i Shoqërisë i konsideron të arsyeshëm sipas rrethanave. Rezultatet e tyre përbejnë bazën për vlerësimin e vlerësimit për t'u mbartur të aktiveve dhe detyrimeve për të cilat nuk janë dhënë informacione shpjeguese në burime të tjera. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga vlerësimet që ishin bërë.

Vlerësimet dhe perlllogaritjet themelore janë rishikuar në vazhdimësi. Rishikimi i vlerësimeve kontabel është njohur në periudhën në të cilën vlerësimi është riparë dhe në çdo periudhë të ardhshme që ndikohet.



ALBPETROL Sh.a.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(Shumat në Lek nëse nuk specifikohet ndryshe)

3. Përmbledhje e politikave kontabël

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj janë konvertuar me normën e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj, në datën e mbylljes së bilancit konvertohen në Lek sipas normës së këmbimit që aplikohet në atë ditë. Diferencat nga konvertimi paraqiten në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj, të deklaruara me kosto historike konvertohen sipas normës së këmbimit në datën e transaksionit.

Diferencat e këmbimit të lindura nga konvertimi i investimit neto të shoqërisë mëmë janë njohur si një zë i veçantë në kapitalin e Shoqërisë.

Kurset kryesore të këmbimit ndaj Lekut janë:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
1 EUR	140.20 Lek	139.59 Lek
1 USD	101.86 Lek	102.85 Lek

3.2 Instrumentet financiare

Instrumentat financiarë jo-derivative përfshijnë investimet në aksione, kërkesa të arketueshme nga klientet, të tjera kërkesa të arketueshme, mjete monetare dhe të ngjashme, kredi të dhena dhe të marra, llogari të pagueshme të tregëteve.

Instrumentat financiarë jo-derivative janë njohur fillimisht me vlerën e drejte plus të gjitha kostot e transaksionit që i perkasin në mënyrë të drejtperdrejte.

- Mjete monetare dhe ekuivalente të mjeteve monetare

Mjete monetare dhe ekuivalente të mjeteve monetare përfshijnë gjendjet e llogarive dhe depozitat që mund të terhiqen menjëherë. Ekuivalente të mjeteve monetare përfshijnë gjithashtu depozita afatshkurtra me pak se tre muaj.

- Investimet të prezantuara me vlerën e drejte nepermjet pasqyres se të ardhurave

Një instrument financiar është klasifikuar si i vlerësuar me vlerën e drejte nepermjet pasqyres se të ardhurave nëse është i mbajtur për t'u shitur. Instrumentat financiarë përcaktohen si të vlerësuar me vlerën e drejte nepermjet pasqyres se të ardhurave nëse Shoqëria i manaxhon këto investime dhe merr vendimet për blerjen dhe shitjen e tyre bazuar në vlerën e drejte. Pas njohjes fillestare, kostot e lidhura drejtpërdrejtë me transaksionin njihen si të ardhura dhe shpenzime kur ato ndodhin. Këto instrumente financiare vlerësohen me vlerën e drejte dhe ndryshimet perkatese njihen si të ardhura ose shpenzime të periudhës ushtrimore.



ALBPETROL Sh.a.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(Shumat në Lek nëse nuk specifikohet ndryshe)

– Kapitali aksioner

Kapitali i aksionerëve të Shoqërisë së njihet me vlerë nominale.

– Dividendët

Dividendët njihen si detyrim në periudhën në të cilën ata deklarohen.

– Te tjera

Instrumentet e tjerë financiare jo derivative vlerësohen me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, minus humbjen nga rivlerësimi, si me poshtë:

Llogarite e arketueshme tregtare dhe të tjerat janë paraqitur me koston e amortizuar minus humbjet nga zhvlerësimi. Pasqyrat financiare përfshijnë provizione speciale në lidhje me llogarite e arketueshme të dyshimta, të cilat sipas opinionit të organeve drejtuese të Shoqërisë, reflektojnë në mënyrë të mjaftueshme humbjen e përfshirë në ato llogari, mbledhja e të cilave është e dyshimte. Përcaktimi i mjaftueshme risë së provizionit nga ana e organeve drejtuese është bazuar, ndër të tjerave edhe në vlerësimin e rrezikshmërisë, duke konsideruar informacionin në dispozicion për bilancin e debitorit, volumin e aktivitetit të tyre tregtar dhe garancive të marra prej tyre.

Llogarite e arketueshme afatgjata janë deklaruar me vlerën e tyre aktuale.



ALBPETROL Sh.a.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(Shumat në Lek nëse nuk specifikohet ndryshe)

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

3.3 Aktive afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale paraqiten të rivlerësuara, përveç tokës, paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rivlerësimi.

Kostot përfshijnë shpenzime që janë kryer drejtpërsëdrejti për blerjen e aktivitetit. Kostot e aktiveve të ndërtuara nga vete shoqëria, përfshijnë koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore, si dhe ndonjë kosto tjetër që lidhet direkt me vënien e aktivitetit në kushte pune, si dhe kostot e çmontimit dhe të zhvendosjes dhe të magazinimit të tyre në vend ndodhjen përkatëse. Kostot e financimit në lidhje me blerjen apo ndërtimin e aktiveve specifik njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me të ndodhur.

Kur pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale kanë jetë të dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentë kryesor) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitja e një zëri të aktiveve afatgjata materiale vendosen duke krahasuar të ardhurat monetare nga shitja me vlerën e mbartur të aktiveve afatgjata materiale, dhe njihen neto brenda zërit "të ardhura të tjera" në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Kur aktivitetet e rivlerësuara shiten, sasi të përfshira në rezervën së rivlerësimit transferohen në fitimin e mbajtur, ndërsa mungesa e rivlerësimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimit të periudhës.

(ii) Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën mbartur të një zëri nëse është e mundur që përfitime ekonomike të ardhshme të trupëzuara në pjesë do të qarkullojnë në Shoqëri dhe kostoja e saj mund të vlerësohet besueshëm. Vlera e mbartur e pjesëve të zëvendësuara nuk njihet. Kostoja e shërbimeve ditore të aktiveve të qëndrueshme njihet në pasqyrën e të ardhurave e shpenzimeve kur ndodhin.



ALBPETROL Sh.a.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(Shumat në Lek nëse nuk specifikohet ndryshe)

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

3.3 Aktivet Afatgjata Materiale (vazhdim)

(c) Amortizimi

Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave e shpenzimeve me baze lineare për ndërtesat dhe lidhjet teknologjike, puset, tubacione, mbi bazën e jetës së dobishme të vlerësuar të çdo pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale dhe me metodën zbritëse për makineritë dhe pajisjet, mjetet e transportit, pajisjet e zyrës dhe kompjuterike, dhe aktivet e tjera me një normë amortizimi siç shpjeguar më poshtë. Toka dhe punimet në proces nuk amortizohen. Më poshtë janë përafërsime të jetës së dobishme:

	2013	2012
<u>Baze lineare</u>		
• Ndërtesa	1.5%	1.5%
• lidhjet teknologjike, puset, tubacione	1.5%	1.5%
<u>Metoda zbritëse</u>		
• Makineri dhe pajisje	2.5%	2.5%
• Pajisje, e te tjera	3 %	3 %

3.4 Aktive afatgjata jo materiale

(ci) Emri i mire

Emri i mire njihet në blerjen e filialeve, *joint ventures* dhe aktiviteteve.

Emri i mire përfaqëson tepricën midis koston të blerjes me interesin e Shoqërisë në vlerën e drejte të aktiveve, detyrimeve dhe detyrimeve të mundshme të shitësit. Në rast se teprica është negative (emri i mire negativ) është njohur menjëherë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Matja pas njohjes fillestare

Emri i mire matet me kosto minus humbjet nga zhvlerësimi.

3.5 Te tjera Aktive Afatgjata Jo materiale

Te tjera aktive afatgjata jo-materiale përfshijnë marka, marrëdhënie me klientë, rjet shpërndarjeje dhe marrëveshje për mos konkurrencë kur këto janë blere.

Amortizimi

Aktivitet Afatgjata Jo materiale të cilat kanë një jetë të dobishme të fundme, janë vlerësuar si diferencë e vlerës historike me amortizimin e akumuluar dhe humbjeve nga zhvlerësimi. Amortizimi është njohur si shpenzim në mënyrë lineare në baze të jetës së dobishme të aktivitet nga data që aktiviteti ka qenë në dispozicion të Shoqërisë.



ALBPETROL Sh.a.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(Shumat në Lek nëse nuk specifikohet ndryshe)

Normat vjetore te amortizimit janë si me poshtë (metoda lineare)

	<u>Ne %</u>
Te tjera aktive	10 %

Emri i mire dhe aktivet me jete te pafundme nuk amortizohen.

3.6 Inventari

Inventari është paraqitur me vlerën me te ulet mes kostos dhe vlerës se realizueshme neto. Kosto është llogaritur si vijon:

- Lendet e para* – Me koston e blerjes dhe inventari i inët kosto blerje minus konsumin e llogaritur.
- Prodhime ne proces* – Me kosto ne baze te metodës se mesatares se ponderuar
- Produkt i gatshëm* – Me kosto ne baze te metodës se mesatares se ponderuar



ALBPETROL Sh.a.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(Shumat në Lek nëse nuk specifikohet ndryshe)

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

3.7 Zhvlerësimi (rënia në vlerë)

(i) Aktivët financiarë

Një aktiv financiar konsiderohet si i zhvlerësuar në ato raste kur ekzistojnë evidencat objektive që tregojnë se një apo me shumë ngjarje kanë patur efekt negativ në flukset e ardhshme të pasasë së atij aktivi.

Humbja nga zhvlerësimi lidhur me një aktiv financiar të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferenca midis vlerës kontabël të aktivit dhe vlerës ekzistuese të flukseve të ardhshme të pasasë, e aktualizuar me normën origjinale efektive të interesit të aktivit.

Llogaritja e arketueshme me një kohëzgjatje të shkurtër nuk aktualizohet. Aktivët e rëndësishme financiarë testohen në mënyrë të veçantë për zhvlerësime të mundshme. Aktivët e mbetura financiarë vlerësohen mbi bazë grupesh që kanë karakteristika të ngjashme të riskut të kredisë. Te gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave. Një humbje nga zhvlerësimi kthehet mbrapsht nëse kthimi mund të lidhet objektivisht me ngjarje që ndodhin pasi ky zhvlerësim është njohur.

(ii) Aktivët jo financiarë

Vlera e mbartur e aktiveve jo financiarë të Shoqërisë, përveç inventarit dhe tatimit të shtyre, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka gjasa për zhvlerësim. Në rast se evidentohet mundësia për zhvlerësim, atëherë riperçaktohet vlera e rikuperueshme e aktivit. Për aktivët e jo materiale që nuk janë të gatshme për përdorim, vlera e rikuperueshme përlllogaritet në çdo datë të bilancit.

Një zhvlerësim njihet atëherë kur vlera kontabël e një aktivi apo vlera e flukseve që do të gjenerojë, është më e madhe se vlera e rikuperueshme e aktivit. Vlera e flukseve që gjenerohen është grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron flukse të pasasë që janë kryesisht të pavarur nga aktivët dhe grupet e tjera. Humbjet nga zhvlerësimet njihen në pasqyrën e fitimeve dhe humbjeve. Për të vlerësuar vlerën në përdorim, flukset e ardhshme të parashikuara të pasasë aktualizohen nga vlera e tyre ekzistuese duke përdorur një normë aktualizimi pa llogaritur tatimet, e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut të vlerës monetare në kohë dhe rreziqet specifike që kanë lidhje me atë aktiv.

Për sa i përket aktiveve të tjera, humbja nga zhvlerësimi kthehet nëse ka shenja që kjo humbje nuk ekziston më dhe ka pasur një ndryshim në përlllogaritjet e përdorura për të përcaktuar shumën e rikuperueshme. Një humbje nga zhvlerësimi kthehet vetëm deri në shkallën që gjendja e mbartur e aktivit nuk është më e madhe se gjendja e mbartur që do të ishte përcaktuar, neto e zhvlerësimit dhe amortizimit, në rast se nuk ka qene njohur asnjë humbje nga zhvlerësimi.



ALBPETROL Sh.a.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(Shumat në Lek nëse nuk specifikohet ndryshe)

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

3.8 Përfitimet e punonjësve

(i) *Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore*

Shoqëria paguan vetëm kontribute të detyrueshme të sigurimeve shoqërore që u sigurojnë përfitime pensioni punonjësve pas daljes në pension. Qeveria shqiptare është përgjegjëse për sigurimin e kufirit minimal të caktuar me ligj për pensionet në Shqipëri sipas një plani të përcaktuar kontributësh pensioni. Kontributet e Shoqërisë në planin e përfitimit të pensioneve ngarkohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve atëherë kur ndodhin.

(ii) *Opsioni i pagesës me aksione*

Vlera e drejte ne datën e dhurimit të opsioneve punonjësve njihet si një shpenzim për punonjësit, që i korrespondon një rritje në kapitalin neto, mbi periudhën në të cilën punonjësit i lind e drejta e pakushtëzuar për këto opsione aksionesh. Shuma e njohur si shpenzim rregullohet në mënyrë që të reflektojë numrin real të opsioneve të aksioneve që dhurohen.

(iii) *Leje vjetore e paguar*

Shoqëria njihet si detyrim shumë të paskontuar të kostove të parashikuara lidhur me lejen vjetore që pritet të paguhet në këmbim të shërbimit të punonjësve për periudhën e përfunduar.

3.9 Provizionet për rreziqet

Provizionet njihen kur Shoqëria ka një detyrim aktual (ligjor ose të tërthortë) si rezultat i një ngjarjeje në të kaluarën dhe ka mundësi që do të nevojitet një fluks burimesh që përfshin përfitimet ekonomike për të përmbushur detyrimin dhe në këtë mënyrë mund të behet një përlogaritje e besueshme e shumës së detyrimit. Në rast se efekti është material, provizionet janë përcaktuar duke skontuar flukset e pritshme të pasasë me normën e uljes para tatimeve, e cila reflekton vlerën kohore të pasasë në kushtet aktuale të tregut dhe, aty ku është e përshtatshme, normën e riskut të pasiveve specifike. Provizionet rishikohen në çdo datë bilanci dhe nëse nuk ka me mundësi për nevojën e një fluksi burimesh që përfshin përfitimet ekonomike për shlyerjen e detyrimit, provizionet kthehen. Provizionet përdoren vetëm për qëllimin që janë njohur fillimisht. Ato nuk njihen për humbjet e ardhshme operative. Aktivitetet e kushtëzuara nuk njihen.



ALBPETROL Sh.a.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(Shumat në Lek nëse nuk specifikohet ndryshe)

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

3.10 Njohja e të ardhurave

(i) Mallrat e shitur

Të ardhurat nga shitja e naftës dhe gazit janë matur me vlerën e drejtë të pagesave të arkëtuara ose të arkëtueshme, pakësuar me tatimet dhe taksat mbi shitjet dhe mbi fitimin (akcizat, taksat e rrugës, dhe të tjera të ngjashme). Te ardhurat nga shitja e mallrave janë matur me vlerën e drejte te pagesave te arkëtuara ose te për tu arkëtuar, pakësuar me tatimet dhe taksat mbi shitjet. Të ardhurat nga shitja janë vlerësuar me vlerën e drejte te kompesimit te marre, neto nga kthimet, uljet tregtare, uljet mbi volumet dhe rabatet. E ardhura është njohur kur rreziqet dhe te drejtat mbi produktet i kalojnë në një pjesë të rëndësishme blesës, marrja e kompesimit është e mundshme, kostot e lidhura dhe kthimet e mundshme të mallrave mund të maten me besueshmeri dhe nuk ka me përfshirje të vazhdueshme të drejtimit të Shoqërisë me këto produkte.

(ii) Të ardhurat nga qiraja

Kosto fikse të qerazë për këto linja të lidhura shpenzohen në bazë të metodës lineare mbi kushtet e qerazë. Shpenzimet e lindura nga qiratë operative njihen në pasqyrën e të ardhurave në bazë të metodës lineare sipas kohëzgjatjes së qirasës.

(iii) Shpenzimet operative

Shpenzimet operative njihen atëherë kur ndodhin.

(iv) Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesi i balancave me bankat dhe të ardhurat nga këmbimi valutë që njihen si fitime ose humbje. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazë rrjedhëse, duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë humbjet nga këmbimi valutë.

(v) Tatim Fitimi

Tatim fitimi apo humbjet e vitit përbëhen nga tatimi aktual dhe ai i shtyre. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital. Tatimi aktual është tatimi i prituri për t'u paguar mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si edhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyre llogaritet duke përdorur metodën e bilancit kontabël, duke sjelle diferenca të përkohshme midis vlerës kontabël të aktiveve dhe pasiveve për raportin financiar dhe vlerës kontabël për qëllime tatimi. Diferencat e përkohshme nuk parashikohen për njohjen fillestare të aktiveve dhe pasiveve që nuk kanë asnjë ndikim mbi kontabilitetin apo fitimin e tatueshëm. Shuma e tatimit të shtyre bazohet në mënyrën e pritshme të realizimit apo shlyerjes së shumës së akumuluar të aktiveve dhe pasiveve, duke përdorur normat tatimore në fuqi në datën e bilancit.

Një aktiv i detyrimit të shtyre njihet vetëm nëse ka të ngjarë që fitimet e ardhshme të tatueshme do të jenë në dispozicion, e ndaj të cilave aktiviteti mund të përdoret. Aktiviteti i tatimit të shtyre reduktohet deri në shkallën ku nuk është me të mundur që të realizohet përfitimi përkatës nga tatimi.



ALBPETROL Sh.a.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(Shumat në Lek nëse nuk specifikohet ndryshe)

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

3.11 Adoptimi i standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar dhe të rishikuara (SNRF).

Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale

Ndryshimet e mëposhtme në standardet ekzistuese të hartuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe interpretimet e hartuara nga Komiteti Ndërkombëtar i Interpretimeve të Raportimit Financiar janë në fuqi për këtë periudhë:

